



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 525 Prot.

Vlorë, më 14/02/2024

**Lënda :** Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Sekuestros)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE  
DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV



- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse



Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të një akti administrativ – Vendimi “Për rikuperimin me force të detyrimeve doganore” si vijon :

- Nr.516 Prot., datë 13/02/2024, i materializuar për subjektin “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Hasan Tasin”, objekti nr.924, kati i parë).

Bashkëngjitur, gjeni kopje origjinale të aktit të lartcitur - gjithsej 2 (dy) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**KRYETAR**  
**Artan Bedinaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 516 Prot.

Vlorë, më 13/02/2024

**VENDIM**

**“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori - subjekti “Medical Maseda” sh.p.k me NIPT M06608201K, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.**

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.68, me Nr.1875/1 Prot., datë 28/08/2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 1,265,998 (Njëmilion e dyqind e gjashtëdhjet e pesëmijë e nëntëqind e nëntëdhjet e tetë) lekë, për deklaratën doganore IMP.4 – R 12389, datë 04/12/2020, si dhe penalitetin doganor në masën e trefishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 3,797,994 (Tremilion e shtatëqind e nëntëdhjeteshtatëmijë e nëntëqind e nëntëdhjet e katër) lekë, bazuar në nenin 258/1/a të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Hasan Tasin”, objekti nr.924, kati i parë), me përfaqësues ligjor z.Davide Lo Conte.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1875/2 Prot., datë 29/08/2023, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresën nr.2932 Prot., datë 22.09.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë, e cila ka konfirmuar shpalljen publike me shkresën e saj Nr.864/1 Prot., datë 29.09.2023 me lëndë “Mbi Shpalljen Publike të aktit administrativ me nr.68, datë 28.08.2023”; me shkresën nr.2933 Prot., datë 22.09.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)”, drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka konfirmuar shpalljen publike me shkresën e saj Nr.11301/1 Prot., datë 09.10.2023 me lëndë “Mbi kërkesën për konfirmim të shpalljes”; me shkresën Nr.3058 Prot., datë 03/10/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrative (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer shpalljen publike në websit-in e saj në kolonën

“Njoftime” (me shkresën e saj Nr.16757 Prot., datë 06/10/2023). Gjithashtu, akti administrativ Vendimi i kontabilizimit Nr.68, me Nr.1875/1 Prot., datë 28/08/2023, i është njoftuar subjektit edhe me anë të njoftimit elektronik me anë të email-it të datës 09/10/2023, ora 09:21, me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – Vendimit të kontabilizimit nr.68, dt.28-08-2023”.

Personi juridik debitor “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 68, me Nr.1875/1 Prot., datë 28/08/2023, si dhe ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, i cili, me Vendimin Nr.19908/1 Prot., datë 16/01/2024, ka vendosur : 1.Mospranimin e ankimit nr.19908 prot., D.P.D datë 10.11.2023 të operatorit ekonomik “Medical Maseda” sh.p.k me NIPT M06608201K, kundër vendimit nr.68 (nr.1875/1 prot., datë 29.08.2023) të Degës së Doganës Vlorë. 2.Ky ankim konsiderohet sikur nuk është bërë. 3.Kundër këtij vendimi keni të drejtën e ankimit pranë gjykatës brenda afatit ligjor. Gjithashtu, rezulton se në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë, është administruar shkresa Nr.3552 Prot., datë 15/141/2023, me lëndë “Kërkesë (Vënie në dispozicion)”, të cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.3552/1 Prot., datë 23/11/2023, me lëndë “Kthim përgjigje”.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.68, me Nr.1875/1 Prot., datë 28/08/2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

#### **V E N D O S A :**

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, apo garantuesit/garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik - “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 5,063,992 (Pesëmilion e gjashtëdhjet e tremijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr. 68, me Nr.1875/1 Prot., datë 28/08/2023, të Degës së Doganës Vlorë.

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**

